

**VËSHTRIM KRITIK MBI LIBRIN "DIJETARË SHQIPTARË  
NË PERANDORINË OSMANE (1880-1912)"**

Sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman, të autorëve Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi, Ramadan Shkodra, botoi "Dituria Islame", Prishtinë, 2021.

Libri "Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)", i autorëve Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra, në qendër të vëmendjes ka biografite e rreth 200 personaliteteve shqiptare të besimit islam, të cilët në gjysmën e dytë të shekullit XIX e deri në vitin e katastrofës kombëtare të 1912, i takonin sa elitës kulturore dhe shpirtërore myslimane si tërësi në kuadër të Perandorisë Osmane, po aq edhe elitës intelektuale dhe kulturore shqiptare. Ndonëse si përkufizim kohor është marrë periudha nga viti 1880 e deri më 1912, të cilën autorët e shpjegojnë me faktin se në Perandorinë Osmane nga ai vit fillojnë të mblihdhen zyrtarisht të dhënat personale të punësuarve në institucionet fetare dhe arsimore të Kryesisë së Bashkësisë Islame (Meshihatit të Lartë Osman) të Perandorisë Osmane, jetëshkrimet e ofruara dëshmojnë edhe veprimtaritë e tyre për periudhën historike edhe të gjysmës së parë të shekullit XIX. Me rëndësi për historiografinë shqiptare është fakti se nga këto të dhëna personale, të mbështetura në dokumente arkivore të Meshihatit të Lartë Os-

man, në Arkivin Osman të Stambollit, në Biblioteka dhe literaturë, zbardhen shumë dëshmi mbi historinë ekonomike, arsimore, kulturore, politike e religjioze të zonave të banuara nga shqiptarët, disa nga të cilat, sot përfshihen në kuadër të shteteve fqinje. Fillimisht duhet theksuar se me depërtimin e osmanëve në Evropën Juglindore, ata hasën në rezistencën e popullsisë vendase, në mesin e të cilëve, shqiptarët dhe hungarezët, ishin ata që i rezistuan më gjatë furisë dhe fuqisë së Perandorisë Osmane. Ndërkohë, me kalimin e kohës, gradualisht, ashtu sikur popujt e tjerë të Ballkanit, shqiptarët filluan të adaptohen, të konvertohen dhe të integrohen në kuadër të sistemit politiko-ushtarak dhe social të Perandorisë Osmane, duke u bërë pjesë institucionale të elitës mbietnike të qytetërimit osman. Dukuri kjo që kishte ndodhur edhe më herët me popujt që jetonin nën Perandorinë Romake e Bizantine. Dhe ndonëse, figurat historike dhe fetare nga zonat ilire, si: Perandori Justinian, nën të cilin u ndërtuar Kisha - Xhamija-Muzeu i njohur Aja Sofija në Kostandinopojë, më vonë

Stamboll, apo kompozitori i këngës kishtare “Te deum” Niket Dardani, ose të shenjtët e krishterë nga Dardania: Flori dhe Lauri, apo Shën Jeronimi, përkthyesi në gjuhën latine i Biblës etj., nuk ishin se kishin kontribuar për lartësimin dhe fisnikërimin e ilirëve, por të qytetërimit romakobizantin dhe të krishterimit, kjo sot nuk na pengon që ne të krenohemi me prejardhjen e tyre ilire, ose së paku si banorë të zonave ilire. Nga ky këndvështrim duhet shikuar dhe vlerësuar edhe veprimtarinë e asaj pjese të popullsisë shqiptare, e cila si e islamizuar, u bë pjesë e rëndësishme e aparatit perandorak osman. Rrjedhimisht, libri i autorëve Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra, dëshmon me të dhëna burimore arkivore, se kontributi i personaliteve të trajtuara, nuk ishte vetëm në shërbim të jetës shpirtërore të banorëve myslimanë të zonave shqiptare, por edhe në krijimin e elitës së re kulturore dhe politike shqiptare. Pra, kishin të bënim me përpjekjen për kultivimin e identitetit të dyfishtë të shqiptarëve; atë osman, që shihej nga elita islame si nevojë për të mbijetuar para aspiratave pushtuese të shteteve fqinje dhe përkrahësve të tyre, si dhe në atë etnik, do të thotë shqiptar. Për më shumë, në vitet 70 të shek. XIX dhe deri në Lidhjen e Prizrenit, një pjesë e elitës politike dhe kulturore osmane, përfshirë edhe Sulltan Abdylhamitin II, i cili e fliste gjuhën shqipe, fillimisht ishin për krijimin e një vilajeti shqiptar, por edhe për përdorimin e shkronjave latine si alfa-

bet i shqipes. Mjerisht, me hedhjen edhe të hapit tjetër domethënës; atë të krijimit të parlamentit të parë osman më 1877, kur përfundimisht po thyheshin heshtat me rrymat konservatore osmane, si përpjekje për t’u modernizuar Perandoria Osmane, ashtu sikur kishte vepruar Japonia, vjen goditja rrënuese e Rusisë cariste, e përcjellë me vrasje dhe dëbime të popullsisë myslimane, ndaj të cilave shtetet evropiane u treguan indiferente. Prandaj, nuk habit fakti që edhe në vitin 1949, në takimin ndërmjet Enver Hoxhës dhe Stalinit, udhëheqësi sovjetik do të potenconte se serbët dhe të tjerët i urrejnë shqiptarët, jo vetëm për përkatësinë e tyre etnike, por edhe ngase ishin myslimanë. Kjo urrejtje religjioze pa dyshim forcoi shumë rrymën politike radikale në shoqërinë osmane që mbështeste idenë e kozmopolitizmit mesjetar, sipas së cilës elementi fetar është bazamenti kryesor identitar i popullsisë myslimane. Argument shtesë për qëndrimin antievropian të kësaj rryme politike osmane ishte edhe fakti se Fuqitë Evropiane nuk intervenuan për të dënuar Rusinë cariste, ashtu sikur ishin obliguar me marrëveshjen e Parisit të vitit 1856, sipas së cilës, garantohej integriteti dhe sovraniteti territorial i Perandorisë Osmane. Rrjedhimisht, Kongresi i Berlinit, pos që theu principin e sovranitetit territorial, duke shpallur Serbinë dhe Malin e Zi si shtete të pavarura, ata heshtazi përligjën edhe politikën e spastrimit etnik. Po kështu, konflikti ruso-osman (1877-78), do të vështirë-

sonde rrënjësisht edhe pozitën financiare të Perandorisë Osmane. Si rezultat i drejtpërdrejtë i kësaj lufte ishte edhe dëmshpërblimi që Perandoria Osmane duhej t'i paguante Rusisë Cariste, vlerë kjo që sillej në rreth 4 miliardë franga ose 160.000.000 funte britanike, e barasvlershme sot me 14 miliardë e 320 milionë funte britanike. Prandaj, pjesëtarët më të ngritur të elitës kulturore dhe politike shqiptaro-osmane, sikur dëshmohej edhe nga të dhënat e këtij libri, ishin të vetëdijshëm se si popullsi evropiane dhe në fqinjësi me shtetet-kombe të Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe të Bullgarisë, nuk kishin si të mos përpiqeshin për institucionalizimin e identitetit të tyre etnik, pavarësisht atij religjioz, si mënyrë të vetme të shpëtimit nga rreziku i copëtimit të atdheut dhe dëbimit të tyre. Kjo në anën tjetër, shpjegon edhe arsyen pse strukturat politike dhe kulturore shqiptare që organizuan Lidhjen e Prizrenit (1878) ishin njëkohësisht edhe pjesë të elitës institucionale osmane. Me fjalë të tjera, shqiptarët, edhe pse të brumosur me kulturë religjioze islame, duke kuptuar momentin historik, nuk hezitonin të pranonin edhe domosdoshmërinë e përpilimit të alfabetit për gjuhën shqipe, madje edhe me shkronja latine. Kjo dëshmohej edhe nga jetëshkrimet e paraqitura në këtë libër, në të cilën përfshihen shqiptarë të përzgjedhur nga të katër vilajetet shqiptare (Kosovës, Manastirit, Janinës dhe të Shkodrës). Kështu, Hafiz Maliq Efendi Nezir Bektashi (Gjakova), ka

shërbyer si myfti në Krujë (1907), mësimdhënës i teologjisë ose myderriz në medresenë e Shijakut (1909), ishte pjesëmarrës në mbrojtjen e Shkodrës si dhe në luftën e Vlorës kundër italianëve (1920). Hafiz Aziz Efendi Kurtishi (Prizreni), mësimdhënës i teologjisë në medresenë e Prizrenit, ka bashkëpunuar me Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Isa Boletinin, etj. Mehmet Emin Efendi Mufitiu-Rrotlla, që rridhte nga oxhaku i Rrotllajve të Prizrenit, ishte deputet i parlamentit të parë osman (1877), nga i cili kishte dhënë dorëheqje duke u rreshtuar në krahë të kërkesave politike të Lidhjes së Prizrenit dhe njëkohësisht nuk ishte kundër përdorimit të alfabetit latin për të shkruar gjuhën shqipe. Ymer Prizreni, udhëheqësi i Lidhjes së Prizrenit, ishte myderriz në medresenë "Mehmet Pasha" të Prizrenit. Rexhep Efendi Voka (Tetovë), pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit (1908), më 1909, kishte botuar me alfabet arab abetaren e gjuhës shqipe. Ismailhaki Efendi Manastiri, ligjërues në xhamitë kryesore të Stambollit, ishte anëtar aktiv i Komitetit Shqiptar të Stambollit dhe një nga shoqëruesit e Sulltan Mehmet Reshatit gjatë vizitës së tij në Vilajetin e Kosovës, më 1911. Vildan Efendi Dibra, si përfaqësues i Komitetit të Stambollit në Kongresin e Manastirit, përkrahte shkrimin e gjuhës shqipe me alfabet latin, duke arsyetuar se edhe turqit-osmanë nuk i kishin shkronjat e tyre, por i përdornin ato të arabëve. Gjithashtu nga të dhënat biografike mësojmë edhe

mbi sistemin arsimor në Perandorinë Osmane, i cili ashtu si në Evropë, e kishte bërë obligues arsimin bazik të nënshtetasve të saj dhe për të qenë në nivel sa më të lartë, në zonat evropiane të saj, respektivisht në vilajetet me popullsi shumicë shqiptare, investonte në infrastrukturën shkollore. Pra, nuk bëhej fjalë për mungesë të investimeve në sistemin arsimor, sidomos në zonat shqiptare, por pikësepari në insistimin që shkollimi të bëhej në gjuhën osmane dhe me alfabet arab, me çka pengohej institucionalizimi i gjuhës shqipe dhe kombit shqiptar, duke ndihmuar pa qëllim tendencat hegjemoniste të shteteve të reja dhe nacionaliste fqinje. Njëkohësisht nga të dhënat e paraqitura shohim edhe fenomenin e largimit të njerëzve të shkolluar nga zonat periferike të Perandorisë Osmane, respektivisht nga zonat shqiptare drejt kryeqendrës, Stambollit dhe qyteteve të tjera të mëdha. Pra, edhe në atë periudhë kemi një rrjedhje të trurit, e cila, sidomos do të intensifikohej pas copëtimit të hapësirave të banuara me shumicë shqiptare, çka jo pak ka ndikuar edhe në procesin e konsolidimit të shtetit të cunguar shqiptar. Natyrisht, edhe pas botimit të këtij libri, do të vazhdojë debati lidhur me rolin e elitës shqiptaro-osmane në kuadër të institucioneve perandorake dhe kritikave se ajo nuk ka bërë aq sa duhej në kërkesat për autonomi të Shqipërisë.

**Memli KRASNIQI**